



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201402138/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën Qershor-Gusht 2014 për fëmijët A, M, S, F, të cilët janë përfitues të statusit të jetimit.*

Drejtuar: Kryetarit të Komunës Paskuqan

TIRANË

Zoti Kryetar,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi M.B, në përmbajtjen e së cilës ankohet për mosdhënien e ndihmës ekonomike për mbesën dhe nipërit e tij, A, M, S, F, të cilët gëzojnë statusin e jetimit.

Sipas shpjegimeve të tij, ankuesi është kujdestar i fëmijëve të sipërpërmendur, të cilët janë përfitues të statusit të jetimit që nga vitit 2013. Nga ana e Komunës Paskuqan, pas dixhitalizimit të sistemit për aplikim të ndihmës ekonomike në kuadër të zbatimit të projektit pilot, u bë një gabim në sistem, ku këta fëmijë jetim nuk figuronin në një trung familjar me të. Për këtë arsye nuk e përfituan ndihmën e ekonomike, që për çdo jetim është 3000 lekë. Pas kërkesave të shumta të tij, iu dha e drejta e përfitimit të masës së ndihmës ekonomike vetëm nga muaji Tetor 2014 dhe jo për periudhën Qershor-Gusht 2014.

Shtetasi M.B, e konsideron këtë çështje si shkelje të të drejtave të ligjshme të mbesës dhe nipërve të tij jetimë, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi, i takojnë të përfitojnë ndihmën e ekonomike për periudhën Qershor-Gusht 2014 dhe ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për shqyrtimin e këtij rasti dhe mundësimimin e përfitimit të ndihmës ekonomike të fëmijëve jetimë të sipërcituar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Bazuar në dokumentacionin bashkangjitur ankesës, konstatojmë se mbesa dhe nipërit e tij jetimë kanë përfitur statusin e jetimit që prej vitit 2013. Me Vendimin nr.23 datë 30.01.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Kukës ka vendosur:

".... Vendosjen në kujdestari të të miturve A.B e datëndjes 05.12.1996, M.B, ii datëlindjes 30.10.1997, S.B i datëlindjes 26.05.2002 dhe F.B i datëlindjes 14.02.2005, duke përcaktuar si kujdestar xhaxhain e tyre, kërkuesin M.B...".

Sipas çertifikatës familjare të lëshuar nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile, Paskuqan, më datë 26.09.2014, rezulton se të katër fëmijët jetimë figurojnë në të njëjtin trung familjar me shtetasin M.B, kryefamiljar.

Në analizë të akteve ligjore dhe nënligjore për dhënien e ndihmës ekonomike për personat që kanë përfitur statusin e jetimit, konstatojmë se Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.787 datë 14.12.2005 "*Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike*", i ndryshuar, në Kapitullin 1. Kriteret dhe dokumnetacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike, në pikën 1 ka përcaktuar se:

"Përfitojnë ndihmë ekonomike:

...b. Jetimët e papunë, mbi 25 vjeç

c. Jetimët, të cilët nuk janë në institucione.."

Ndërsa në Kapitullin III. Masa e përfitimit të ndihmës ekonomike, në pikën 21 ka përcaktuar se:

"Masa e ndihmës ekonomike për çdo jetim të përcaktuar në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 1, të këtij vendimi, është 3000(tre mijë) lekë në muaj".

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se: "Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

REKOMANDOJMË:

Dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën Qershor-Gusht 2014 për fëmijët A, M, S, F, të cilët janë përfitues të statusit të jetimit.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një

rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit",

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI